



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.857/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Milena Đerić kryesuese, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Suharekës, Bashkim Ndrecaj nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Suharekë paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.857/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Suharekës, Bashkim Ndrecaj nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Suharekë paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilë ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet VV 2401A/02R, VV 2401A/06R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1001/2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Suharekës, Bashkim Ndrecaj nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se në vendvotimet VV 2401A/02R, VV 2401A/06R ka mospërputhje të votave ashtu që nga Formulari i Regjistrimit të Kandidatëve që shërben për vëzhguesit nga subjekti, vëzhguesi i tyre ka dërguar formular në parti me votat e kandidatëve të subjektit dhe ai ka pasur 23 vota derisa nga KQZ-ja i janë regjistruar vetëm 20 vota ashtu që i mungojnë 3 vota. Andaj përmes apelit ka kërkuar nga PZAP të aprovojë apelin dhe ta urdhërojë KQZ-në që të bëjë rinumërimin të votave në vendvotimet e lartëcekura. Apelit i ka bashkangjitur Formularin e Rezultati të Kandidatëve, Formularin e Përputhjes së të Dhënave si dhe Raportin e Vëzhguesit të Subjektit Politik LDK.

Apeli është i pabazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, nga Raporti i Vëzhguesit i Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, kandidati në fjalë ka gjithsej 23 vota derisa në Formularin e Rezultatit të Kandidatit ka gjithsej vetëm 3 vota mirëpo pas verifikimit të bërë nga të dhënat zyrtare të ofruara nga KQZ rezulton se kandidati në fjalë në këto dy vendvotime ka gjithsej 23 vota ashtu siç edhe pretendon, andaj paneli gjeti se pretendimet e tij nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkrete por janë vetëm pretendime të supozuara andaj këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Për arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.857/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuese e Panelit

Milena Deric

Milena



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.